



Rr. "Abdi Toptani", ish Hotel Drini



info@kmshc.al



www.kmshc.al

22 Janar 2024

# NJOFTIM

## PËR PËRMBYLLJEN E PROCESIT TË INSPEKTIMIT NË BASHKINË KAVAJË DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR LIGJSHMËRINË

Me urdhrin nr. 74, datë 02.10.2023, Komisioneri ka nisur procesin e inspektimit të rasteve të emërimit dhe largimit të nëpunësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në Bashkinë Kavajë.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 5, datë 22.01.2024, të Komisionerit ku janë lënë detyra për të rregulluar ligjshmërinë lidhur me:

- -Procesin e rivlerësimit për përcaktimin e vendeve të punës që do të trajtohen si pjesë e shërbimit civil, duke rakorduar veprimet edhe me Komisionerin;
- -Procesin e hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës;
- -Procesin e hartimit dhe miratimit të planit të rekrutimit brenda afateve ligjore, për vitin 2024;
- -Realizimin e procedurave të konkurrimit për të gjitha vendet vakante të shërbimit civil në kuptim të ligjit;
- -Konstatimin e pavlefshmërisë absolute nga ana e Kryetarit të Bashkisë Kavajë, të akteve të emërimit për punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin;
- Plotësimin e dosjeve të personelit, me të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej ligjit, si dhe evidentimin dhe rikthimin në punë të nëpunësve civilë gjyqfitues dhe dokumentimin e këtyre praktikave.